



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 2701/3 prot.

Tiranë, më 24.01.2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 2701/1, DATË 25.09.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË PARAQITURA NGA SHTETASIT EMILJANO SHULLAZI, GILMANDO DANI, ENDRIT ZELA, BLERIM SHULLAZI”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e bashkuara të shtetasve Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Zela, Blerim Shullazi, me nr. 56 prot., datë 10.02.2020, nr. 56/2 prot., datë 21.02.2020, nr. 56/3 prot., datë 04.03.2020 dhe nr. 56/4 prot., datë 07.04.2020, në të cilat ngrihen pretendime ndaj magjistratëve A. B me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, E. T me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Korçë, A. K me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, S. B dhe ish magjistratit A. V me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Durrës, V. H me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, N. K dhe ish magjistrates N. D me detyrë gjyqtarë në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 2701/1, datë 25.09.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të paraqitura nga shtetasit Emiljano Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Zela, Blerim Shullazi”, bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sipas adresës së lënë nga ankuesit;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

